



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 21.05.2013

Nr. 0-589

PËR: Ramadan Muja, Kryetari i Komunës së Prizrenit
Nijazi Kryeziu, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

LËNDA: Përgjigje në kërkesë

Të nderuar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 02.05.2013, ka pranuar një kërkesë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit për ofrimin e këshillës ligjore, lidhur me formimin e komisionin të ankesave të paraparë me piken 3 dhe 4 të nenit 9 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të kërkesës vlerëson se;

- Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës në nenin 9 pika 3 dhe 4, ka paraparë të drejtën e ankesës për palët e pakënaqura nga procesi i konkurrimit gjatë dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshëm komunale.
- Komunitat kanë për obligim që të formojnë komisionet e ankesave me qëllim të realizimit të të drejtave për palët e pa kënaqura në proces, të garantuar me nenin 9 pika 3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
- Formimi i Komisionit të ankesave dhe përcaktimi i përgjegjësisë së tij përcaktohet me vendim të Kuvendit të Komunës.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 21.05.2013

Br. 0-589

Za : Ramadan Muja, Gradonačelnik Opštine Prizren
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine Opštine Prizren

Predmet: Odgovor na zahtev

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je dana 02.05.2013, primilo jedan zahtev od Predsedavajućeg Skupštine Opštine Prizren za nudjenje pravnog saveta , u vezi sa formiranjem komisije za žalbe predviđene u tački 3 i 4 član 9 Zakona br. 04/L-144 za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posla razmatranja zahteva procenjuje ;

- Zakon br. 04/L-144 za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine u članu 9 tačka 3 i 4, su predvidele pravo na žalbu za nezadovoljene stranke od procesa konkurisanja u toku davanja na korišćenje nepokretne opštinske imovine .
- Opštine imaju obavazu da formiraju komisije za žalbe u cilju realizacije prava za nezadovoljene stranke u procesu, garantovane po članu 9 tačka 3 i 4 Zakona br. 04/L-144 za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine.
- Formiranje Komisije za žalbe i odredjivanje njegove odgovornosti se odredjuje po Odluci Skupštine Opštine .

MALS,je opredeljeno da ponudi podršku i potrebnu pomoć,za potpuno spovodjenje obavaza koje proizilaze od spovodljivog zakonodavstva za lokalnu samoupravu .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.